



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

# SIAHDPC PLANII CILËSISË

univations



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria e Kosovës  
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ministry of Education, Science and Technology

kolegji-heimerer   
Arsim dhe Karriere në Shëndetësi

 ISEE-HSP  
Institute of Southeast Europe  
for Health and Social Policy



jamk.fi  
JAMK University of Applied Sciences

 Metropolia

 UNIVERSITETI  
KADRI ZEKA  
UNIVERSITY



 milkyway  
creative



---

**SIAHDPC  
PLANI I  
CILËSISË**

## QËLLIMI DHE EKIPI

Roli	Zbatuar nga:	Data e Rishikimit	Aprovuar nga:	Data e Aprovimit:
Partner	Univations	4/14/2021	Kerstin Muller	14.4.21
Partner	ISEEHSP	4/14/2021	Dardan Bekaj	14.4.21
Partner	HC	4/14/2021	Ferdane Simnica/ Albin Pllana/	14.4.21
Partner	Metropolia	4/14/2021	Toini Harra	14.5.21
Partner	Digital Clinic	4/14/2021	Dardan Asllani	14.04.2021
LIDER	RIT Kosovo	4/14/2021	Albina Balidemaj	14.5.2021
Partner	JAMK	4/14/2021	Annina Kangas-Niemi	14.4.2021

Qëllimi është të sigurohet që projekti do të përmbushë objektivat e tij siç është planifikuar për sa i përket cilësisë, kohës dhe kostos. Për më tepër, procedurat e kontrollit të cilësisë përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet bashkëpunitorëve dhe metodat e kontrollit të cilësisë. Niveli i lartë i cilësisë arrihet nga monitorimi i rregullt i të gjitha proceseve të paketave punuese, si dhe rezultatet dhe diskutimet reflektuese me menaxherët e projektit dhe grupin punues të projektit. Metoda kryesore është aplikimi i vlerësimit të fuqizuar (empowerment evaluation), i cili për nga natyra e tij është proaktiv dhe korrigjues.

**Ekipi brendshëm i vlerësimit** përbëhet nga përfaqësues nga:

Udhëheqësi i paketës punuese të cilësisë, RIT Kosova, i cili është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së proceseve dhe rezultateve të projektit, i mbështetur nga afër nga partnerë tjerë të projektit, përkatësisht: Univations (Florian Bratzke, Andreas Lauenroth), IEJL-PSS (Dardan Bekaj), KH (Erza Haxhi Jakupi dhe Albin Pllana), Metropolia (Toini Harra), Klinika Digjitale (Dardan Asllani) dhe JAMK (Annina Kangas-Niemi)



## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. HYRJE</b>	<b>5</b>
<b>1.1 QËLLIMI I PLANIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË SË PRO</b>	<b>5</b>
<b>2. PËRMBLEDHJE E SIGURIMIT TË CILËSISË SË PROJEKTIT</b>	<b>5</b>
<b>2.1 DISEMINIMI</b>	<b>5</b>
<b>2.2 MENAXHIMI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>6</b>
<b>3. PAKETAT E PUNËS (E PËRGJITHSHME)</b>	<b>8</b>
<b>4. MENAXHIMI I RREZIKUT TË PROJEKTIT DHE SIGURIA</b>	<b>8</b>
<b>4.1 PLANET KOHORE JANË SHUMË AMBICIOZE OSE AFATET NUK ARRIHEN</b>	<b>9</b>
<b>4.2 PROBLEMET METODOLOGJIKE</b>	<b>9</b>
<b>4.3 SFIDA MENAXHERIALE TË LIDHURA ME BASHKËPUNIMIN TRANSAKSIONAL DHE KOMUNIKIMIN E BRENDSHËM</b>	<b>9</b>
<b>4.4 IDENTIFIKIMI I MOSPËTRPËTHJEVE MIDIS REZULTATEVE DHE OBJEKTIVAVE FILLESTAR</b>	<b>10</b>
<b>4.5 PROBLEMET LIDHUR ME DISEMINIMIN DHE SHFRYTËZIMIN</b>	<b>10</b>

# 1.HYRJJE

## 1.1 QËLLIMI I PLANIT TË SIGURIMIT TË CILËSISË SË PROJEKTIT

Qëllimi është të sigurohet që projekti do të përmbushë objektivat e tij siç është planifikuar për sa i përket cilësisë, kohës dhe kostos. Për më tepër, procedurat e kontrollit të cilësisë përmirësojnë bashkëpunimin ndërmjet bashkëpunëtorëve dhe metodat e sigurimit të cilësisë. Niveli i lartë i cilësisë arrihet nga monitorimi i rregullt i të gjitha proceseve të paketave punuese, si dhe rezultatet dhe diskutimet reflektuese me menaxherët e projektit dhe grupin punues të projektit. Metoda kryesore është aplikimi i vlerësimit të fuqizuar (empowerment evaluation), i cili për nga natyra e tij është proaktiv dhe korrigjues.

Është përgjegjësi e të gjithë menaxherëve të përfshirë në projekt që të jenë të vetëdijshëm për sfidat që lidhen me sigurimin e cilësisë, menaxhimin e rrezikut dhe të kenë parasysh natyrën ndërkombëtare të ekipit në projekt. Megjithatë, teknika e menaxhimit të cilësisë që përdoret brenda projektit SIAHDPC përfshin procedura të gjera që ruajnë komunikimin ndërpersonal të sjellshëm, efikas dhe të frytshëm. Kur zbatohen në praktikë procedurat e sigurimit të cilësisë, ekipi punon ngushtë me grupin drejtues, ekipin e projektit dhe ekipin e menaxhimit të projektit, duke përfshirë modifikimin e tyre sipas nevojës.

## 2. PËRMBLEDHJE E SIGURIMIT TË CILËSISË SË PROJEKTIT

Ekipi i Cilësisë së bashku me ekipin menaxherial të projektit do të monitorojë nëse aktivitetet në paketat e punës 1, 2, 3, 4, 6, 7 do të bëhen sipas përshkrimit të projektit dhe për të ndihmuar ekipin e menaxhimit të projektit dhe pjesën tjetër të ekipit punues për të gjetur mënyra efektive për të bërë ndryshimet e nevojshme për të arritur të gjitha rezultatet e premtuara.

### 2.1 DISEMINIMI

- Sigurimi i një strategjie të diseminimit të projektit për të siguruar mirëkuptimin e ndërsjellë të aktiviteteve promovuese të SIAHDPC dhe për të rënë dakord për masat diseminuese;
- Sigurimi i secilit partner të një plani të diseminimi;
- Përfshirje proaktive e secilit partner në aktivitetet e marketingut të lidhura me SIAHDPC;
- Prezantimi dhe dokumentimi i projektit të SIAHDPC në takime dhe evente të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Integrimi i logos dhe identitetit vizual të SIAHDPC në kanalet dhe platformat e komunikimit;
- Respektimi dhe përdorimi i vazhdueshëm i partneritetit të SIAHDPC për identitetin vizual të rënë dakord (përfshirë dizajnin e BE-së dhe të korporatës);
- Përgatitja dhe sigurimi i mbulimit të mjaftueshëm mediatik gjatë gjithë jetës së projektit;
- Zhvillimi i burimeve të marketingut me cilësi të lartë (baner, broshurë, fletushka, prezantim, etj.) bazuar në dakordimet e të gjithë partnerëve të SIAHDPC;
- Sigurimi i dëshmimeve në nivel të lartë për të promovuar projektin e SIAHDPC në mënyrë adekuate.

## 2.2 MENAXHIMI I PËRGJITHSHËM

- Dorëzimi i fletëve të orëve të punës që secili partner nënshkruan si dëshmi të pjesëmarrjes së tyre në paketat e punës të SIAHDPC;
- Konferenca të rregullta të të gjithë partnerëve të SIAHDPC (të paktën një përfaqësues për partner);
- Raportimi i rregullt mbi progresin e paketës së punës (PP) e ofruar nga drejtuesit përkatës të PP;
- Shkëmbim i rregullt i formalizuar dhe i joformalizuar për arritjet kyçe të SIAHDPC (telefonata bilaterale, E-Mail, takime fizike/digjitale, etj.);
- Pjesëmarrja e të paktën një përfaqësuesi zyrtar nga çdo organizatë partnere në takimet e partnerëve të SIAHDPC (takime digjitale ose fizike të grupeve të plota);
- Sigurimi i standardeve të zakonshme për takimet e partnerëve (salla e takimeve, tabela e bardhë, Wi-Fi, ushqime, etj.) nga institucioni që organizon takimin për të siguruar një nivel të lartë të efikasitetit dhe produktivitetit;
- Përgatitja profesionale e çdo takimi të partnerëve nga institucioni drejtues (fokusi tematik, sigurimi i një agjende takimi të mirëmenduar, moderimi i takimeve dhe diskutimeve, etj.);
- Sigurimi i procesverbaleve të takimeve për çdo takim të partnerit si dokument i përbashkët për detyrat e punës të diskutuara dhe të dakorduara brenda partneritetit;
- Sigurimi i procesverbaleve të takimeve për çdo video-konferencë si dokument i përbashkët për detyrat e punës të diskutuara dhe të dakorduara brenda partneritetit;
- Ofrohet një dizajn vizualisht tërheqës për projektin, i përshtatshëm për grupin shënjestër dhe me një strukturë të fortë (logo, markë, shkrim, ngjyrat zyrtare, shabllone për dokumentet Word dhe PowerPoint, etj.).
- Përputhshmëria brenda organizatave dhe integrimi i dizajnit të projektit SIAHDPC;
- Sigurimi i planit të projektit bazuar në projekt propozim dhe i përditësuar rregullisht në bazë të nevojave gjatë gjithë jetës së projektit;
- Sigurimi i një platforme për ndarjen e dokumenteve e cila është e qasshme për të gjithë partnerët me të drejtat të barabarta;
- Marrëveshja për kushtet për të drejtat e pronësisë intelektuale përmes IPR-së në përputhje me standardet e BE-së (burime të hapura arsimore / krijimtari të përbashkëta);
- Vlerësimi pas çdo takimi të partnerit me një anketë;
- Anketa afatmesme mbi progresin e projektit, menaxhimin drejtues, komunikimin, etj. Ofruar nga Grupi i Menaxhimit të Projektit;
- Vullnetarizëm i ndërsjellë për të korigjuar/kontrolluar në drejtshkrim tekstet, prezantimet e SIAHDPC, etj. nga të gjithë partnerët;
- Vlerësimi i jashtëm: Përdorni Anketat e Formave të Google, si një metodologji praktike për t'u përdorur brenda Ekipit të Cilësisë gjatë fazës së zbatimit. Ndërsa aktivitetet janë të ndryshme në çdo ngjarje, pyetësi duhet t'i përshtatë ndryshimet dhe t'i shpërndajë ato tek të gjithë pjesëmarrësit që morën pjesë në ngjarje;
- Mbledhja e rezultateve pas çdo takimi dhe përgatitja e një raport të shkurtër i cili do të publikohet në një google drive/ WP 5 – Plani i Cilësisë, i cili përdoret për të përmirësuar ngjarjen e radhës;
- Ndarja në Google drive e të gjitha dokumentet përkatëse;
- Rubrika që do të përdoren;
- Lista e objektivave dhe rezultateve të dorëzuara - Lista përfshin listat e kontrollit, listat e kontrollit të pakove të tjera të punës, takimet/aktivitetet, agjendat e moduleve, procesverbalet e takimeve, rishikimet nga anëtarë të tjerë të ekipit, informacione shtesë të rëndësishme për secilin ngjarje/event dhe afatet kohore, vlerësime fuqizuese si instrumentet dhe raportet.

- Raporti i progresit të grupit të studimit: Ky raport është shkruar për grupin udhëheqës (1 faqe) për të dhënë vlerësim mbi gjendjen aktuale të grupit të studimit (kur);
- Sistemi i rishikimit nga kolegët: një sistem i përbashkët i zhvilluar ndërmjet partnerëve. Qëllimi është të ndihmohen partnerët për të vlerësuar rezultatet e zhvilluara. (kur);
- Raportet për monitorimin periodik do të hartohen nga ekipi i brendshëm i vlerësimit të projektit, do t'i raportohen grupit udhëheqës dhe do të publikohen në platformën digjitale. (kur);
- Orari i vlerësimit të takimeve - Linjë kohore e bazuar në datat e takimeve/përshkrimi i temave, etj te partnerëve të SIAHDPC;
- Sigurimi i rekomandimeve të nivelit të lartë për të promovuar burimet e SIAHDPC në mënyrë adekuate.

E gjithë përmbajtja e hartuar dhe materiali cilësor do të ndahen me vlerësuesin e jashtëm dhe vizitat gjatë vitit të dytë dhe të fundit të projektit. Eksperti i jashtëm angazhohet për të fituar njohuri mbi mënyrën se si arrihen objektivat e projektit dhe për të adresuar çdo problem sapo të shfaqet. Vëmendja e veçantë është e orientuar drejt cilësisë së aktiviteteve të Zhvillimit Profesional të Vazhdushëm.

Vlerësuesi i jashtëm do të japë komente duke i raportuar institucionit koordinues të projektit (Kolegji Heimerer-KH) dhe duke marrë pjesë në disa nga takimet e grupit të cilësisë. KH koordinon vizitat dhe raportet e vlerësuesit të jashtëm. Përveç kësaj, do të shpërndajë të gjitha raportet e vlerësimit të jashtëm tek grupi i cilësisë, grupi udhëheqës dhe pjesëmarrësit e tjerë të projektit. Secili prej këtyre grupeve/pjesëmarrësve do të përcaktojë formatin e diskutimit të raporteve para afateve, duke përdorur e-mail dhe/ose mjete të tjera, p.sh., takime në Skype, video konferenca dhe një platformë të përbashkët digjitale.

### 3. PAKETAT E PUNËS (E PËRGJITHSHME)

- Sigurimi i versioneve dyfish të kontrolluara;
- Sasia e drejtë e punës së ndarë për të gjeneruar WP (Paketat e Punës) brenda partneritetit për të siguruar motivimin e lartë të çdo partneri;
- Ofrimi i dëshmive nga ata që kanë shfrytëzuar me sukses burimet e SIAHDPC (ku është e aplikueshme).

### 4. MENAXHIMI I RREZIKUT TË PROJEKTIT DHE SIGURIA

Megjithatë, në projekte ka shumë rreziqe, të cilat përkojnë me sfidat që mund të evidentohen përmes monitorimit të cilësisë. Raportet për monitorimin periodik do të hartohen nga ekipi i brendshëm i vlerësimit të projektit, do të raportohet te grupi drejtues dhe do të publikohen në platformën digjitale. Elementet e përmendura përfshijnë vetëm disa kategori rreziqesh, të ndjekura nga një deklaratë e shkurtër mbi mënyrën se si monitorimi i cilësisë mund të ndihmojë në identifikimin e masave të kundërveprimit ose në kapërcimin e këtyre sfidave.







## 4.4 IDENTIFIKIMI I MOSPËRPTHJEVE MIDIS REZULTATEVE DHE OBJEKTIVAVE FILLESTAR

Plani i punës i projektit parashikon disa pikë kyçe për arritjen e rezultateve, të cilat janë të lidhura ngushtë me objektivat e përcaktuara. Vlerësimi do të realizohet periodikisht gjatë ose pas takimeve me partnerë, në përputhje me rezultatet e pritura duke shfrytëzuar mjete dhe metoda të tjera vlerësuese. Ky mekanizëm do t'u ofrojë menaxherëve të projektit dhe partnerëve mundësinë për të rregulluar aktivitetet dhe veprimet nëse rezultatet e arritura nuk përkojnë me objektivat e projektit. Vlerësimi i materialeve të zhvilluara gjatë testeve pilot do të ofrojë informacion të rëndësishëm nga grupi shënjestër dhe do të analizohen me qëllim përmirësimin e rezultateve të projektit.

## 4.5 PROBLEMET LIDHUR ME DISEMINIMIN DHE SHFRYTËZIMIN

Aktivitetet e diseminimit dhe shfrytëzimit do të jenë një çështje kyçe e diskutimit në të gjitha takimet e partnerëve të SIAHDPC-së dhe në shumicën e takimeve online. Ekipi i menaxhimit të projektit do të mbikëqyrë monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të diseminimit dhe shfrytëzimit dhe garantimin e arritjes së objektivave të deklaruara të diseminimit dhe shfrytëzimit. RIT Kosova do të mbikëqyrë të gjitha aktivitetet e lidhura me cilësinë brenda konsorciumit SIAHDPC dhe do të sigurojë që të gjitha detyrat e menaxhimit të cilësisë të shpërndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partnerëve bazuar në përgjegjësitë e tyre brenda projektit si dhe në aftësitë e tyre specifike.

univations



koleggi-heimerer   
Arnim dhe Karriere në Shëndetësi



jamk.fi  
JAMK University of Applied Sciences







Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

# SIAHDPC PLANII CILĒSISĒ